




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br Prot. <u>01-368/14</u>
Dep.	Prot No.
Nr. i faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>30.01.2014</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	29/01/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Enver DURMISHI Menaxher i Departamentit të Prokurimit në Doganën e Kosovës
CC:	z. Lulzim RAFUNA Drejtor i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Servisimi i rregullt, mirëmbajtja dhe furnizimi, ndërrimi dhe balancimi me goma për automjetet të Doganës së Kosovës të tipit Volkswagen"

I nderuari z. Durmishi

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Servisimi i rregullt, mirëmbajtja dhe furnizimi, ndërrimi dhe balancimi me goma për automjetet të Doganës së Kosovës të tipit Volkswagen" me nr. të prokurimit: 201 133 13 027 211, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Servisimi i rregullt, mirëmbajtja dhe furnizimi, ndërrimi dhe balancimi me goma për automjetet të Doganës së Kosovës të tipit Volkswagen" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit në Doganën e Kosovës ka përgatitë “ Njoftimin për Kontratë ” me titull “Servisimi i rregullt, mirëmbajtja dhe furnizimi, ndërrimi dhe balancimi me goma për automjetet të Doganës së Kosovës të tipit Volkswagen“ me nr. prokurimi: 201 133 13 027 211, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 14.01.2014, në Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të këtij aktiviteti të prokurimit në “Njoftimin për Kontratë”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në “Njoftimin për Kontratë” të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, më datë 14.01.2014, tek pika III.2.4 e rubrikës “Kapaciteti teknik dhe profesional”, pika b. është kërkuar Deklaratë e Operatorit Ekonomik se Autoservisi për shërbimet e pjesës së parë dhe hapësira për furnizimim, ndërrimin dhe balancimin e gomave nuk gjendet në një largësi më të madhe se 15 km nga objekti i Qeverisë së Kosovës (Ndërtesa e ish Rilindjes), e obligueshme për të dy pjesët I dhe II , Gjithashtu e njëjta pikë është përshkruar edhe në “Dosjen e Tenderit“ , që ka përgaditur A.K për këtë tender , pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues Dogana e Kosovës me formulimin e këtij kriteri tek pika b. e “Njoftimit për Kontratë” dhe “Dosjes së Tenderit“, ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik ku thuhet se “Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik“, duke i diskriminuar Operatorët Ekonomik që janë në largësi më tepër se 15 km favorizohen Operatorët Ekonomik që janë më afër se 15 km.

Kriteret e lartëcekura në pikën III.2.4 të Rubrikës “Kapaciteti teknik dhe profesional”, siç janë përshkruar në “Njoftimin për Kontratë” dhe “Dosjen e Tenderit”, bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi janë kritere diskriminuese dhe në këtë mënyrë eliminojnë konkurrencën e lirë duke favorizuar Operatorët e caktuar Ekonomik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me, nenin 7 Barazia në Trajtim Jo-Diskriminimi të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !